

# FTESË PËR PARAQITJEN E KANDIDATURËS



Sezione di Albanologia  
*Dega e Albanologjisë*



PËR NDJEKJEN E **SHKOLLËS VERORE TË ALBANOLOGJISË DHE TË BALLKANISTIKËS (SEIAB)** E TË **SHKOLLËS VERORE NDËRKOMBËTARE TË ITALIANISTIKËS (SEII)**.

---

Kjo ftesë është botuar në datën 08/06/2010 dhe skadon me 15/06/2010.

Klasifikimi i përkohshëm i fituesve do të botohet në datën 20/06/2010 dhe ai përfundimtar në datën 24/06/2010.

## SKEMA E FTESËS

### 1. INFORMACION RRETH SHKOLLAVE VERORE NDËRKOMBËTARE

### 2. PËRMBAJTJA E FTESËS

2.1 NR. 30 VENDE TË PARASHIKUARA PËR KANDIDATË NGA UNIVERSITETET ITALIANE PËR NDJEKJEN E **SHKOLLËS VERORE NDËRKOMBËTARE TË ALBANOLOGJISË DHE TË BALLKANISTIKËS - SEIAB**.

2.2 NR. 30 VENDE TË PARASHIKUARA PËR KANDIDATË NGA UNIVERSITETET E EVROPËS JUGLINDORE PËR NDJEKJEN E **SHKOLLËS VERORE NDËRKOMBËTARE TË ALBANOLOGJISË DHE TË BALLKANISTIKËS-SEIAB (7 VENDE)** DHE TË **SHKOLLËS VERORE NDËRKOMBËTARE TË ITALIANISTIKËS-SEII (23 VENDE)**.

### 3. VLERËSIMI I KANDIDATURAVE DHE I “BURSAVE TË STUDIMIT”

### 4. FORMULARI I APLIKIMIT ON – LINE

### 5. SEKRETARIA ORGANIZUESE



PËR NDJEKJEN E **SHKOLLËS VERORE TË ALBANOLOGJISË DHE TË BALLKANISTIKËS** (SEIAB) E TË **SHKOLLËS VERORE NDËRKOMBËTARE TË ITALIANISTIKËS** (SEII).

## 1. INFORMACION MBI SHKOLLAT VERORE NDËRKOMBËTARE

Projekti VATRA –për dialog ndërkulturor mes Italisë dhe Ballkanit- bën pjesë si nën-projekt – nr.6, i Projektit të përgjithshëm “Infrastruktura kulturore & Territore”, përfshirë në Linjën 2.4 “Dialog dhe kulturë” – të Marrëveshjes së Programit Kornizë “Program për mbështetjen e bashkëpunimit rajonal mes Italisë dhe vendeve të Ballkanit” (APQ-Ballkan).


Projekti VATRA parashikon realizimin e dy linjave të formimit të lartë:

- **Shkolla Verore Ndërkombëtare e Italianistikës** (SEII);
- **Shkolla Verore Ndërkombëtare e Albanologjisë dhe e Ballkanistikës** (SEIAB).

Kjo nismë angazhon studentë si nga Evropa juglindore ashtu dhe nga rajone të ndryshme italiane.

Plani mësimor i dy shkollave verore parashikon një total prej 96 orësh (12 kredite):

- 60 orë leksione, 30 prej të cilave të përbashkëta për të dyja shkollat e 30 të tjerat të parashikuara për leksione të veçanta për secilën prej tyre;
- 36 orë parashikohen për ekskursione në terren, konferenca, projekte filmash e dokumentarësh të ndryshëm, prezantime librash etj.



Këto dy shkolla verore ndërkombëtare, me seli në Kalabri, Altopiano Silano, në Camigliatello (Cosenza), **do të fillojnë me 12 korrik dhe do të përfundojnë me 23 korrik 2010.**

Për informacione të mëtejshme:

- <http://www.linguistica.unical.it/VATRA>
- <http://www.torrecamigliati.it/index.htm> (selia e shkollave verore Scuola di Management Territoriale pranë "Torre Camigliati", në Camigliatello Silano –Cosenza)
- <http://www.hotel-lafenice.it/> (selia e shkollave verore dhe e rezidencës Hotel La Fenice në Camigliatello Silano –Cosenza).

## Projekti VATRA – për dialog ndërkulturor mes Italisë dhe Ballkanit.

Nismë e realizuar në kuadër të projektit të përgjithshëm “ICT”, financuar nga APQ Ballkan, Linja 2.4 Dialog e kulturë, në zbatim të “Programit për mbështetje e bashkëpunim Rajonal”, me fonde shtetërore dhe rajonale italiane.

# FTESE PËR PARAQITJEN E KANDIDATURËS



PËR NDJEKJEN E **SHKOLLËS VERORE TË ALBANOLOGJISË DHE TË BALLKANISTIKËS** (SEIAB) E TË **SHKOLLËS VERORE NDËRKOMBËTARE TË ITALIANISTIKËS** (SEII).

---

## 2. PËRMBAJTJA E FTESËS

### 2.1 I NR. 30 VENDE TË PARASHIKUARA PËR KANDIDATË NGA UNIVERSITETET ITALIANE PËR NDJEKJEN E **SHKOLLËS VERORE NDËRKOMBËTARE TË ALBANOLOGJISË DHE TË BALLKANISTIKËS -SEIAB.**

#### 2.1.1. Modulet

Kandidati mund të paraqesë kërkesën për pranim në dy nga modulet e mëposhtme të gjuhës që ofron kjo shkollë verore, duke i renditur sipas preferencës:

- GJUHË SHQIPE niveli FILLESTAR
- GJUHË SHQIPE niveli i PËRPARUAR
- GJUHË RUMUNE niveli FILLESTAR
- GJUHË SERBE e KROATE niveli FILLESTAR

#### 2.1.2 Plani mësimor:

**Numri i krediteve:** 12

**Numri i orëve:** 96 orë, 60 prej të cilave janë seminare të organizuara mbi bazë mësimdhënieje dhe 36 të tjera seminare të organizuara mbi bazë ekskursionesh, konferencash, projekte filmash dhe dokumentarësh, prezantime librash nga autorë të ndryshëm, etj.

**Seminaret  
e parashikuara:  
(60 orë)**

- Filologji, gjuhësi, kulturë dhe histori e Ballkanit (20 orë)
- Ludo – linguistikë e glotodidaktikë (10 orë)

Moduli i gjuhës me zgjedhje (30 orë):

- Gjuhë shqipe - niveli fillestar (20 orë), Filologji dhe gjuhësi shqipe (10 orë)
- Gjuhë shqipe – niveli i përparuar (20 orë), Filologji dhe gjuhësi shqipe (10 orë)
- Gjuhë rumune – niveli fillestar (20 orë), Filologji dhe gjuhësi rumune (10 orë)
- Gjuhë serbe e kroate – niveli bazë (20 orë), Filologji e gjuhësi sllave (10 orë)

Leksionet do të mbahen nga e hëna deri të premten: katër orë paradite dhe dy orë pasdite.

# FTESË PËR PARAQITJEN E KANDIDATURËS



PËR NDJEKJEN E **SHKOLLËS VERORE TË ALBANOLOGJISË DHE TË BALLKANISTIKËS** (SEIAB) E TË **SHKOLLËS VERORE NDËRKOMBËTARE TË ITALIANISTIKËS** (SEII).

## 2.1.3 Krite pranimi

Vendet e disponueshme për ndjekjen e shkollës verore parashikohen për ata kandidatë që vijnë nga një prej universiteve italiane dhe përmbushin këto krite:

|   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | TITULLI I STUDIMIT NË FUSHËN HUMANISTIKE<br><i>i kryer apo në proces</i> |                                                   |                                                            |                                                   |                                                     |           |
|---|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|-----------------------------------------------------|-----------|
|   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | Diplomë e nivelit të parë (3 vjet)                                       | Master i nivelit të parë                          | Diplomë e nivelit të dytë (2 vjet)                         | Diplomë 4 ose 5-vjeçare                           | Master i nivelit të dytë                            | Doktoratë |
| 1 | Mosha maksimale                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | 35                                                                       | 35                                                | 38                                                         | 38                                                | 38                                                  | 38        |
| 2 | Numri minimal i krediteve universitare të kryera                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | 1/3 e krediteve të parashikuara në planin mësimor (60/180)               | 1/3 e krediteve të parashikuara në planin mësimor | 1/3 e krediteve të parashikuara në planin mësimor (40/120) | 1/3 e provimeve të parashikuara në planin mësimor | 1/3 d e krediteve të parashikuara në planin mësimor |           |
| 3 | Mesatarja minimale e notave<br>- Sistemi universitar italian                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | 27 / 30                                                                  | 27 / 30                                           | 27 /30                                                     | 27 /30                                            | 27 /30                                              | 27 /30    |
|   | - sistemi universitar i Evropës juglindore                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | 8,5 /10                                                                  | 8,5 /10                                           | 8,5 /10                                                    | 8,5 /10                                           | 8,5 /10                                             | 8,5 /10   |
| 4 | Niveli minimal i njohjes së gjuhës, i certifikuar.<br>Çertifikimi i njohjes minimale të gjuhës <u>parashikohet vetëm për ndjekjen e kurseve të përparuara të gjuhës</u> (shqip e italisht). Si dëshmi vlejné provimet pranë institucioneve universitare apo enteve të akredituara.<br>Fituesit do t'i nënshtrohen një testi për verifikimin e nivelit të njohjes së gjuhës. | B2                                                                       | B2                                                | B2                                                         | B2                                                | B2                                                  | B2        |

## Projekti VATRA – për dialog ndërkulturor mes Italisë dhe Ballkanit.

Nismë e realizuar në kuadër të projektit të përgjithshëm “ICT”, financuar nga APQ Ballkan, Linja 2.4 Dialog e kulturë, në zbatim të “Programit për mbështetje e bashkëpunim Rajonal”, me fonde shtetërore dhe rajonale italiane.

# FTESË PËR PARAQITJEN E KANDIDATURËS



Sezione di Albanologia  
*Dega e Albanologjisë*



PËR NDJEKJEN E **SHKOLLËS VERORE TË ALBANOLOGJISË DHE TË BALLKANISTIKËS** (SEIAB) E TË **SHKOLLËS VERORE NDËRKOMBËTARE TË ITALIANISTIKËS** (SEII).

---

## 2.1.4 Shpërndarja e vendeve dhe e “bursave të studimit”

Nr. 30 vende të disponueshme, ku 15 të parët trajtohen me “bursë studimi” që mbulon shpenzimet e udhëtimit, qëndrimit dhe regjistrimit, sipas shpërndarjes së mëposhtme:

- nr. 10 vende ku 5 të parët me “bursë studimi” të rezervuara për studimin e gjuhës shqipe, niveli fillestar;
- nr. 6 vende ku 4 të parët me “bursë studimi” të rezervuara për studimin e gjuhës shqipe, niveli i përparuar;
- nr. 7 vende të rezervuara për studimin e gjuhës rumune, ku 3 të parët trajtohen me “bursë studimi”
- nr. 7 vende të rezervuara për studimin e gjuhës serbe e kroate, ku 3 të parët trajtohen me “bursë studimi”.

“Bursa e studimit” e parashikuar për studentët nga universitetet italiane mbulon shpenzimet e qëndrimit (strehim dhe ushqim) dhe të regjistrimit.

# FTESË PËR PARAQITJEN E KANDIDATURËS



**Sezione di Albanologia**  
**Dega e Albanologjisë**



PËR NDJEKJEN E **SHKOLLËS VERORE TË ALBANOLOGJISË DHE TË BALLKANISTIKËS** (SEIAB) E TË **SHKOLLËS VERORE NDËRKOMBËTARE TË ITALIANISTIKËS** (SEII).

---

**2.2 NR. 30 VENDE TË PARASHIKUARA PËR KANDIDATË NGA UNIVERSITETET E EVROPËS JUGLINDORE PËR NDJEKJEN E SHKOLLËS VERORE NDËRKOMBËTARE TË ALBANOLOGJISË DHE TË BALLKANISTIKËS–SEIAB (7 VENDE) DHE TË SHKOLLËS VERORE NDËRKOMBËTARE TË ITALIANISTIKËS–SEII (23 VENDE).**

## 2.2.1 Modulet

Kandidati mund të paraqesë kërkesën e tij për dy prej moduleve të gjuhës së ofruar duke i renditur sipas preferencës:

- GJUHË ITALIANE (niveli FILLESTAR)
- GJUHË ITALIANE (niveli i PËRPARUAR)
- GJUHË SHQIPE (niveli i PËRPARUAR)
- GJUHË RUMUNE (niveli FILLESTAR)
- GJUHË SERBE E KROATE (niveli FILLESTAR)

## 2.2.2 Plani mësimor

**Numri i krediteve:** 12

**Numri i orëve :** 96 orë, 60 prej të cilave janë seminare të organizuara mbi bazë mësimdhënieje dhe 36 të tjera seminare të organizuara mbi bazë ekskursionesh, konferencash, projektme filmash dhe dokumentarësh, prezantime librash nga autorë të ndryshëm, etj

**Seminare  
të parashikuara:  
(60 orë)**

- Filologji, gjuhësi, kulturë dhe histori e Ballkanit (20 orë)
- Ludo - linguistikë e glotodidaktikë (10 orë)

Moduli i gjuhës me zgjedhje (30 orë):

- Gjuhë italiane – niveli fillestar (20 orë), Filologji e gjuhësi italiane (10 orë);
- Gjuhë italiane – niveli i përparuar (20 orë), Filologji e gjuhësi italiane (10 orë);
- Gjuhë shqipe – niveli i përparuar (20 orë), Filologji e gjuhësi shqipe (10 orë);
- Gjuhë rumune – niveli fillestar (20 orë), Filologji e gjuhësi rumune (10 orë);
- Gjuhë serbe e kroate – niveli fillestar (20 orë), Filologji e gjuhësi sllave (10 orë).

Leksionet do të mbahen nga e hëna deri të premten: katër orë paradite dhe dy orë pasdite.

## **Projekti VATRA – për dialog ndërkulturor mes Italisë dhe Ballkanit.**

Nismë e realizuar në kuadër të projektit të përgjithshëm “ICT”, financuar nga APQ Ballkan, Linja 2.4 Dialog e kulturë, në zbatim të “Programit për mbështetje e bashkëpunim Rajonal”, me fonde shtetërore dhe rajonale italiane.

# FTESË PËR PARAQITJEN E KANDIDATURËS



PËR NDJEKJEN E **SHKOLLËS VERORE TË ALBANOLOGJISË DHE TË BALLKANISTIKËS** (SEIAB) E TË **SHKOLLËS VERORE NDËRKOMBËTARE TË ITALIANISTIKËS** (SEII).

## 2.2.3 Kriteria pranimit

Bursat e studimit janë parashikuar për studentë të diplomuar ose jo (doktorantë apo të doktoruar) që përmbushin këto kriteret të parashikuara për pranim dhe vijnë nga këto universitete të Evropës juglindore, partnerë të projektit VATRA:

- UNIVERSITETI I TIRANËS – FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË;
- UNIVERSITETI I SHKODRËS “L. GURAKUQI”;
- UNIVERSITETI I GJIROKASTRËS “E. ÇABEJ”;
- UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE, TETOVË.

Vendet e disponueshme pa bursë studimi janë parashikuar edhe për ata kandidatë të Evropës juglindore që vijnë nga universitete jopartnerë të këtij projekti dhe përmbushin kriteret e parashikuara për pranim.

|   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | TITULLI I STUDIMIT NË FUSHËN HUMANISTIKE<br><i>i kryer apo në proces</i> |                                                   |                                                            |                                                   |                                                   |           |
|---|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|---------------------------------------------------|-----------|
|   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | Diplomë e nivelit të parë (3 vjet)                                       | Master i nivelit të parë                          | Diplomë e nivelit të dytë (2 vjet)                         | Diplomë 4 ose 5-vjeçare                           | Master i nivelit të dytë                          | Doktoratë |
| 1 | Mosha maksimale                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | 35                                                                       | 35                                                | 38                                                         | 38                                                | 38                                                | 38        |
| 2 | Numri minimal i krediteve universitare të kryera                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | 1/3 e krediteve të parashikuara në planin mësimor (60/180)               | 1/3 e krediteve të parashikuara në planin mësimor | 1/3 e krediteve të parashikuara në planin mësimor (40/120) | 1/3 e provimeve të parashikuara në planin mësimor | 1/3 e krediteve të parashikuara në planin mësimor |           |
| 3 | Mesatarja minimale e notave                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                                                                          |                                                   |                                                            |                                                   |                                                   |           |
|   | - Sistemi universitar italian                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | 27 / 30                                                                  | 27 / 30                                           | 27 / 30                                                    | 27 / 30                                           | 27 / 30                                           | 27 / 30   |
| 4 | - sistemi universitar i Evropës juglindore                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | 8,5 / 10                                                                 | 8,5 / 10                                          | 8,5 / 10                                                   | 8,5 / 10                                          | 8,5 / 10                                          | 8,5 / 10  |
|   | Niveli minimal i njohjes së gjuhës, i certifikuar.<br>Çertifikimi i njohjes minimale të gjuhës parashikohet vetëm për ndjekjen e kurseve të përparuara të gjuhës (shqip e italisht). Si dëshmi vlejné provimet pranë institucioneve universitare apo enteve të akredituara.<br>Fituesit do t'i nënshtrohen një testi për verifikimin e nivelit të njohjes së gjuhës. | B2                                                                       | B2                                                | B2                                                         | B2                                                | B2                                                | B2        |

## Projekti VATRA – për dialog ndërkulturor mes Italisë dhe Ballkanit.

Nismë e realizuar në kuadër të projektit të përgjithshëm “ICT”, financuar nga APQ Ballkan, Linja 2.4 Dialog e kulturë, në zbatim të “Programit për mbështetje e bashkëpunim Rajonal”, me fonde shtetërore dhe rajonale italiane.

# FTESË PËR PARAQITJEN E KANDIDATURËS



Sezione di Albanologia  
**Dega e Albanologjisë**



PËR NDJEKJEN E **SHKOLLËS VERORE TË ALBANOLOGJISË DHE TË BALLKANISTIKËS** (SEIAB) E TË **SHKOLLËS VERORE NDËRKOMBËTARE TË ITALIANISTIKËS** (SEII).

---

## 2.2.4 Shpërndarja e vendeve dhe e “bursave të studimit”:

Nr. 30 vende të disponueshme, ku:

### I. Nr. 25 vende me “bursë studimi” sipas shpërndarjes së mëposhtme:

A. Vende rezervuar për ata kandidatë të cilët plotësojnë kushtet e pranimit të sipërpërmenduar, si dhe vijnë nga këto universitete:

1. UNIVERSITETI I TIRANËS – FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË;
2. UNIVERSITETI I SHKODRËS “L. GURAKUQI”;
3. UNIVERSITETI I GJIROKASTRËS “E. ÇABEJ”;
4. UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE, TETOVË

Shpërndarja e vendeve:

- nr. 10 bursa studimi për ndjekjen e kursit të gjuhës italiane – **niveli fillestar**;
- nr. 8 bursa studimi për ndjekjen e kursit të gjuhës italiane – **niveli i përparuar**;
- nr. 2 bursa studimi për ndjekjen e kursit të gjuhës rumune – **niveli fillestar**

B. Vende rezervuar për ata kandidatë të cilët plotësojnë kushtet e pranimit të sipërpërmenduar, si dhe vijnë nga UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE, TETOVË:

- nr. 3 bursa studimi për ndjekjen e kursit të gjuhës shqipe – **niveli i përparuar**

C. Vende rezervuar për ata kandidatë të cilët plotësojnë kushtet e pranimit të sipërpërmenduar, si dhe vijnë nga këto universitete:

1. UNIVERSITETI I TIRANËS – FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË;
2. UNIVERSITETI I SHKODRËS “L. GURAKUQI”;
3. UNIVERSITETI I GJIROKASTRËS “E. ÇABEJ”;

- nr. 2 bursa studimi për ndjekjen e kursit të gjuhës serbe e kroate – **niveli fillestar**.

II. Nr. 5 vende pa bursë studimi, të rezervuara për ata kandidatë të cilët plotësojnë kushtet e pranimit të sipërpërmenduar, si dhe vijnë nga këto universitete të Evropës juglindore (Bosnja - Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Rumania, Serbia):

Shpërndarja e vendeve:

- Nr. 3 për ndjekjen e kursit të gjuhës italiane – **niveli fillestar**.
- Nr. 2 për ndjekjen e kursit të gjuhës italiane – **niveli i përparuar**.

# FTESË PËR PARAQITJEN E KANDIDATURËS



Sezione di Albanologia  
**Dega e Albanologjisë**



PËR NDJEKJEN E **SHKOLLËS VERORE TË ALBANOLOGJISË DHE TË BALLKANISTIKËS** (SEIAB) E TË **SHKOLLËS VERORE NDËRKOMBËTARE TË ITALIANISTIKËS** (SEII).

### 3. VLERËSIMI I KANDIDATURAVE DHE I “BURSAVE TË STUDIMIT”

Për kryerjen e vlerësimit është e nevojshme që kandidati krahas kërkesës, bashkangjitur të dërgojë edhe dokumentacionin e poshtëshënuar duke specifikuar të gjithë përvojën e tij qoftë kjo universitare apo jo, por në dobi të përzgjedhjes së cilës do t'i nënshtrohet.

|   |                                                                                   |  |
|---|-----------------------------------------------------------------------------------|--|
| 1 | <b>CV në format evropian</b>                                                      |  |
|   | <b>Documentacioni i nevojshëm bashkangjitur CV-së:</b>                            |  |
| 2 | <b>Dëshmi për:</b><br>a) njohjen e gjuhëve të huaja;<br>b) njohuritë informatike. |  |
| 3 | <b>Botime</b>                                                                     |  |
| 4 | <b>Qëllimi i ndjekjes së shkollës verore</b>                                      |  |

Për vlerësimin e kandidaturave do të ketë prioritet numri i provimeve të dhëna në lëndët gjuhësore, letrare, historike dhe demo-antropologjike që kanë lidhje me Evropën Juglindore.

Për caktimin e vendeve të disponueshme, komisioni do të respektojë kriteret vlerësuese të parapërcaktuara, duke u siguruar të paktën një vend përfaqësuesve të selive universitare partnere në projekt, pra të gjitha selive prej nga vijnë studentët, duke zbatuar kriteret –meritë e motivim- siç është parashikuar më sipër.

Rezultati i vlerësimit do të publikohet në faqen e internetit [www.linguistica.unical.it/VATRA](http://www.linguistica.unical.it/VATRA).

“Bursa e studimit” mbulon shpenzimet e qëndrimit (strehim dhe ushqim) për gjatë gjithë kohës së ndjekjes së shkollës.

Ata që do të pranohen pa “bursë studimi” duhet të marrin parasysh përveç shpenzimeve të udhëtimit edhe ato të qëndrimit (strehim dhe ushqim, rreth 600 euro).

### 4. FORMULARI I APLIKIMIT ON - LINE

[www.linguistica.unical.it/candidati-italia](http://www.linguistica.unical.it/candidati-italia)

[www.linguistica.unical.it/candidati-balcani](http://www.linguistica.unical.it/candidati-balcani)

### 5. SEKRETARIA ORGANIZUESE

**Projekti VATRA -për dialog ndërkulturor mes Italisë dhe Ballkanit**

APQ Ballkan. Linja 2.4. Dialog dhe kulturë

Projekti i përfshirë (P.I.) në: “Infrastruktura Kulturore & Territore” (ICT)

Departamenti i Gjuhësisë i Universitetit të Kalabrisë

Ent zbatues i Rajonit të Kalabrisë (Drejtues i nën-projektit)

Telefon: (0039) 0984494140

Fax: (0039) 0984494141

E-mail: [vatra@unical.it](mailto:vatra@unical.it)

### **Projekti VATRA – për dialog ndërkulturor mes Italisë dhe Ballkanit.**

Nismë e realizuar në kuadër të projektit të përgjithshëm “ICT”, financuar nga APQ Ballkan, Linja 2.4 Dialog e kulturë, në zbatim të “Programit për mbështetje e bashkëpunim Rajonal”, me fonde shtetërore dhe rajonale italiane.